



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë: 12.05.2014
Nr.0204-666

PËR: Sokol Bashota, Kryetar i Komunës së Klinës
Haxhi Ibishi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Klinës

LËNDA: KËRKESË PËR RISHQYRTIMIN E VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË KLINËS Nr.464-2806/2014 të pranuar më datën 02.05.2014.

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, duke u bazuar në kompetencat dhe përgjegjësitë e përcaktuara në nenin 81.4 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, si dhe Rregulloren Nr. 02/2011, për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive shtojca XII, pas shqyrtimit të vendimit Nr.464-2806/2014 të miratuar me datën 25.04.2014 nga Kuvendi i Komunës së Klinës, konstaton se:

- Vendim për miratimin e propozimit(gojor) të kryetarit të Komunës së Klinës, lidhur me dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të tokës komunale, pjesë e ngas.kad.nr.567/2, në sipërfaqe të pjesërishme prej 40 m² dhe atë për ndërtimin e objektit të thertores në fshatin Videjë, që do të shërbejë për interesa publike të palëve kontraktuese për qytetarët e atij vendi dhe rrethinës, është i kundërligjshëm.
- Ky Vendim, është në kundërshtim me Ligjin Nr.04/L-144 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, i cili Ligj në nenin 5 potencon se: Procedura për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim afatshkurtër, realizohet përmes konkurrencës së hapur publike dhe procedurave të parapara me këtë ligj.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, duke u bazuar në nenin 81 pika 4 e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, kërkon nga Kuvendi i Komunës së Klinës që të ndërmarrin veprime konkrete që në afat prej 30 ditësh të bëjë rishqyrtimin e këtij vendimi.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendëskryeministër dhe Ministër i MAPL-së

Kopje: ~ Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së
Arkivit të MAPL-së



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datum:12.05.2014
Nr.0204-696

Za: **Sokol Bashota**, Gradonačelnik Opštine Klina
Haxhi Ibishi, Predsedvajući Skupštine Opštine Klina

PREDMET: **ZAHTEV ZA RAZMATRANJE ZAKONITOSTI ODLUKE OPŠTINE KLINA**
BR 464 -2806-2014 primljen dana 02.05 .2014

Poštovani,

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave, na osnovu nadležnosti i odgovornosti određenih u članu 81.4 Zakona za Lokalnu samoupravu, Uredbom Br. 02/2011, o Poljima Administrativne Odgovornosti kabineta Premijera i Ministarstva, dodatak XII, posle razmatranja odluke Br 464-2806-2014-, usvojene dana 25.04.2014 od Skupštine Opštine Klina, konstatuje.

-Odluka o usvajanju usmenog predloga gradonačelnika opštine Klina u vezi sa davanjem na kratkoročno korišćenje opštinske imovine deo katastarske parcele br.562-2 u delimičnoj površini od 40 m2 za izgradnju objekta klanice u selu Videja, koja će služiti za javni interes ugovorenih strana za građane tog mesta i okoline, je protivzakonita.

-Ova Odluka je u suprotnosti sa Zakonom br.04-L-144 za davanje na korišćenje i razmenu nepokretne opštinske imovine, ovaj Zakon u članu 5 naglašava da.-Procedura za davanje na kratkoročno korišćenje nepokretne opštinske imovine se realizuje preko javno otvorene konkurencije i predviđenih procedura sa ovim zakonom.

Ministarstvo Adminitracije lokalne samouprave ,na osnovu člana 81 tačka 4 Zakona za lokalnu samoupravu, traži od Skupštine Opštine Klina da preduzme konkretne mere da u roku od 30 dana ponovo razmotri ovu odluku.

S poštovanjem

Slobodan Petrović,
Zamanik premijera i Ministar MALS-a

Kopija: **Besnik Osmani**, Generalni Sekretar MALS-a
Rukovodiocima Uprava MALS-a
Arhivi MALS-a

HYRESE-ULAZNA-INCOMING
 REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLICA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
 QEVERIA E KOSOVES VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVO

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
 Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
 Ministry of Local Government Administration

Data
 Datum 02.05.2014
 Date

Niveli organizave	Nr. i Lëndës	Shtojca	Vlera
-VI-	0204-666	5	



REPUBLIKA E KOSOVES
 REPUBLIC OF KOSOVO
 REPUBLIKA KOSOVO

www.komuna-klina.org

KOMUNA E KLINES
 MUNICIPALITY OF KLINA
 OPŠTINA KLINA



Duke u mbështetur në nenin 14 dhe 40 paragrafi 40.1 dhe 40.2 nënparagrafi 1) i Ligjit të Vetëqeverisjes Lokale, Nr.03/L-040, nenit 10, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2. i Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, nr.04/L-144, nenit 20 paragrafi 1 dhe 2 nënparagrafi 3.2 të Rregullores së QRK, nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës, si dhe nenit 40 paragrafi 2, nënparagrafi i fundit të Statutit të Komunës së Klinës, si dhe duke lu referuar kërkesës, nr. 01-464-2630/2014 të dt. 25.04.2014 të RTM-Organizata Regio Terzo Mondo me seli në Klinë, si dhe OJQ "Indira", me seli në Videjë dhe, së fundmi duke pasur parasysh edhe propozimin (gojor) të Kryetarit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e IV-të të rregullt për vitin 2014, të mbajtur më 25.04.2014, mori këtë:

VENDIM

I

Miratohet propozimi (gojor) i Kryetarit të Komunës së Klinës lidhur me dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të tokës komunale, pjesë e ngastrës kadastrale nr. 567/2, në sipërfaqe të pjesërishme prej 40 m katrorë dhe atë për ndërtimin e objektit të Thertores në fshatin Videjë, që do të shërbejë për interesa publike të palëve kontraktuese dhe qytetarëve të atij vendi dhe rrethinës.

Afati i shfrytëzimit është afatshkurtër për 10 vite pa kompensim, nga dita e lidhjes dhe nënshkrimit të kontratës.

Toka në sipërfaqen e lartcekur i jepet në shfrytëzim organizatës RTM-Regio Terzo Mondo, si bashkëpunues me OJQ "Indira" me seli në Videjë.

II

Dhënia në shfrytëzim e tokës komunale nga pika 1 e këtij Vendimi bëhet me qëllim të implementimit të projektit -Eured Grant Scheme EU call Ref. Europe Aid/135-174/ACT/XK, për të cilin projekt ka interes publik edhe Komuna e Klinës, sepse objekti i referohet interesave publike të qytetarëve.

III

Mbi bazë të këtij Vendimi në mes të tria palëve: RTM-së, OJQ-së "Indira" dhe Komunës së Klinës, do të lidhet kontratë e veçantë për dhënie në shfrytëzim të tokës komunale për ndërtimin e objektit të thertores në Videjë dhe bashkëmenaxhimin publik të saj.

IV

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është:

1. Kërkesa e RTM dhe "Indira" nr.01-464-2630/2014 e dt. 25.04.2014,
2. Certifikata pronësore për ngastër 567/2 e dt.25.04.2014,
3. Certifikata e regjistrimit të Statutit për RTM e dt. 10.01.2014,
4. Certifikata e nr. fiskal të RTM e dt. 20.11.2009,

5. Certifikata e regjistrimit të OJQ- "Indira" e dt. 11.04.2008,
6. Certifikata e regjistrimit fiskal nr.fiskal të OJQ "Indira" e dt. 30.12.2009, si dhe
7. Tërë dokumentacioni tjetër financiar dhe urbanistik i objektit të thertores.

V

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Klinës, ky Vendim hyn pas përfundimit të procedurës së vërtetimit të ligjshmërisë nga autoriteti mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit të Vetëqeverisjes Lokale.

VI

Me këtë Vendim të njoftohen: MAPL, Kryetari i Komunës, RTM-a, OJQ "Indira", Drejtoria e Urbanizmit dhe MM, Drejtoria e Gjeodezisë dhe Kadastrit, Zyra Ligjore, Zyra për Informim, një kopje për Shërbimin për Punë të Kuvendit dhe një për Arkivin e Komunës së Klinës.

KUVENDI I KOMUNËS SË KLINËS

01Nr. 144-2014 2014
Klinë, më 02.05 2014



Kryesuesi,
Dr. Haxhi Ibishi